



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KRPP - RKIN - PPRC



03/2019

14.01.2019

<b>Për :</b>	<b>Zyrtarët përgjegjës të prokurimit të AK</b>	<b>Kopje</b>	<b>Arkivi të KRPP-së</b>
<b>Përmes:</b>	<b>Osman Vishaj – Kryetar i KRPP-së</b>		
<b>Nga:</b>	<b>Fahri Maxhuni – Koordinator i dep. të monitorimit – KRPP</b>		
<b>Lënda</b>	<b>Njoftim</b>		
<b>Datë:</b>	<b>14.01.2019</b>		

Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

Bazuar në këtë, KRPP kërkon nga të gjithë **Zyrtarët përgjegjës të prokurimit të** Autoriteteve Kontraktuse të Kosovës që të dërgojnë **raportet vjetore për kontratat e nënshkuara publike** për vlera të mëdha, të mesme, të vogla dhe minimale për vitin fiskal 2018, më së largu deri me **31.01.2019** në KRPP.

Meqenëse sistemi gjeneron raportin vjetor të kontratave të nënshkuara publike, të cilat janë zhvilluar përmes platformës së e-prokurimit, nga AK-se kërkohet që raporti të plotësohet me aktivitetet e prokurimit me vlerë minimale dhe procedurat tjera të prokurimit të cilat nuk janë zhvilluar përmes platformës së e-prokurimit.

Formulari B53 - Raporti vjetor mbi kontratat e nënshkuara publike, nxjerret nga platforma elektroniqe, i cili do të plotësohet (kompletësohet) me procedurat të cilat nuk janë të përfshira në raportin e sistemit të E- prokurimit dhe duhet të përgaditet dhe dorëzohen në **formën exel në KRPP**. Gjithashtu, në raport të përfshihen edhe numri i aktiviteteve të anuluar, të ndara sipas vlerës së kontratës.

Adresa elektronike për dërgimin e raporteve është: [shpalljekrpp@rks-gov.net](mailto:shpalljekrpp@rks-gov.net)  
tel: 038-213-710 Formulari B53 Raporti vjetor mbi kontratat e nënshkuara publike (Shkarko te Legjislacioni Sekondar)